



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRIË - OPŠTINA VUČITRN

02 Nr. / Br 729/19

Nr. i fq. / Br. st - 03 -

Data: / Datum 06.06.2019

VUSHTRI - VUČITRN



KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D
MITROVICA
TEL 045 707 520-304
01-337
07.06.19



MITROVICA
KOMPANIA UJËSJELLËSI RAJONAL SH.A
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C
KOMPANIJA REGIONALNI VODOVOD D.D

KOMUNA VUSHTRI

MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI PËR KYÇJE INDIVIDUALE NË RRJETIN E UJËSJELLËSIT

Palët nënshkruese:

1. Kompania Rajonale e Ujësjiellësi "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë, përfaqësuar nga
z. **Sami Miftari**, Kryeshef Ekzekutiv;

dhe
2. Komuna e Vushtrisë, e përfaqësuar nga z. **Xhafer Tahiri**, Kryetari i Komunës.

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është bashkëpunimi për realizimin e projektit "kyçjet individuale të konsumatorëve (ekonomive familjare) në rrjetin e ujësjiellësi në territorin e komunës së Vushtrisë".

Neni 2 Projekti

Projekti "kyçje individuale të konsumatorëve (ekonomive familjare) në rrjetin e ujësjiellësi në territorin e komunës së Vushtrisë", realizohet nga Komuna e Vushtrisë dhe ka për qëllim kyçje e çdo ekonomie familjar në tërë territorin e Komunës së Vushtrisë, duke i furnizuar me ujë të pijshëm.

Neni 3
Obligimet e Kompanisë Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a."

- 3.1 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë merr përsipër që të mos i ngarkoj me tarifa të kyçjes individuale në rrjetin e ujësjetlësit konsumatorët (ekonomitë familjare), përveç ndonjë takse tjetër eventuale e cila është obligative për konsumatorët.
- 3.2 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë, ndërmerr masa të duhura për funksionalizim të fabrikës së ujit në fsh. Balinc 24 orë pa ndërpre, në mënyrë që të iu siguroj furnizimin e qytetarëve me ujë të pijes.
- 3.3 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë, cakton menaxherin/organin mbikëqyrës i cili do të jetë pjesë e grupit menaxhues për realizimin e këtij projekti si dhe për inspektimin final të punimeve/pranimin teknik.
- 3.4 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë do bashkëpunoj me Komunën për rrjedhat e realizimit të projektit sipas një plani dinamik deri në përfundimin e projektit.
- 3.5 Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë do të siguroj 2500 ujëmatës për ekonomitë familjare e cila do të kyçet në rrjetin e ujësjetlësit.

Neni 4
Obligimet e Komunës

- 4.1 Komuna e Vushtrrisë merr përsipër kryerjen e punëve të ndërlidhura nga rrjeti primar i ujësjetlësit deri në pusetën e çdo ekonomie familjare.
- 4.2 Komuna është e obliguar që pasë përfundimit të çdo kyqeje të secilit fshat të beje dorëzim pranimin e projektit tek Kompania Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a."

Neni 5
Ndryshimet e marrëveshjes së mirëkuptimit

Me pëlqimin paraprak të Kryeshefit Ekzekutiv të Kompanisë Rajonale e Ujësjetlësit "Mitrovica sh.a." në Mitrovicë dhe Kryetarit të Komunës, kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

Neni 6
Zgjidhja e mosmarrëveshjes

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim.

Neni 7
Pronësia e projektit

Me pranim dorëzimin e punëve të kryera, ky projekt do të kaloj me automatizëm në pronësi të Kompanisë Rajonale e Ujësjellësit “Mitrovica sh.a.” në Mitrovicë dhe regjistrohet në regjistrin e tyre të pasurisë.

Neni 8
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga dita e nënshkrimit. nga palët e marrëveshjes.

Neni 9
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në katër ekzemplarë në origjinal, nga dy për secilën palë nënshkruese.

KRU “Mitrovica sh.a.”

Sami Miftari, Kryeshf Ekzekutiv



Komuna Vushtrri

Xhafer Tahiri, Kryetar

